

## 915 VARIANTI I PALIDHUR I PIKËQASJES – EMËR VETJAK\*\*

Fusha 915 përdoret në regjistrimet e njësuara, të cilat janë krijuar në mënyrë automatike, bazuar në të dhënat në regjistrimet bibliografike. Gjatë konvertimit fillestar, në fushën e përsëritshme 915 janë transferuar variantet e formave të emrit (variantet e pikëqasjes) nga fushat 901 e 902 në bazën bibliografike, që nuk kanë qenë të lidhura saktë me fushat përkatëse 701 dhe 702 (p.sh. ka munguar nënfusha 7016 për lidhjen e fushave 701 dhe 901, përkatësisht 702 dhe 902).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
915	Varianti i palidhur i pikëqasjes – emër vetjak**	r
	<b>a</b> <i>Elementi hyrës</i>	nr
	<b>b</b> <i>Pjesa tjetër e emrit</i>	nr
	<b>c</b> <i>Shtesa të emrit (jo datat)</i>	r
	<b>d</b> <i>Numra romakë</i>	nr
	<b>f</b> <i>Datat</i>	nr
	<b>5</b> <i>Kodi për marrëdhënien</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Nuk është i përcaktuar</i>
2		<i>Mënyra e shënimit të emrit</i>
	0	<i>shënohet vetëm emri ose emri dhe mbiemri</i>
	1	<i>shënohet mbiemri dhe emri</i>

Treguesi përcakton nëse emri është vendosur në renditje të drejtë (vetëm emri ose emri dhe mbiemri) ose në formë të përmbytur (mbiemri dhe emri).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat nga a deri f janë përshkruar tek fusha 200, ndërsa nënfusha 5 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Pikëqasja në fushën 915 është varianti i formës së emrit.

Për shkak se të dhënat në fushën 915 janë transferuar në mënyrë automatike nga regjistrimet jo të plota bibliografike, duhet të verifikohet nëse bëhet fjalë për variantin e formës së emrit të vendosur në fushën 200.

**SHEMBUJ**

1. \*

200 □1 **a**Maček **b**Jože **r**00338915 □1 **a**Leskovšek **b**Mirko

*(Fusha 901 në regjistrimin bibliografik nuk ka qenë e lidhur me fushën përkatëse 701, për këtë arsye në fushën 915, në regjistrimin e njësuar, është shfaqur një emër i pasaktë.)*